Kronikë

Tiranë/ 50 vjeçari ekzekutohet brenda lokalit 'Kështjella'! Autori i dyshuar kunati i Altin Hajrit! Viktima u ngrit nga tavolina për ta përqafuar, u qëllua nga 27 vjeçari (EMRAT+VIDEO)

Atentati ndodhi rreth orës 15:30, brenda në lokalin "Kështjella", në periferi të Tiranës. Në kërkim 27 vjeçari, i dyshuar si autor, Julian Gjosha, kunati i pronarit të kompleksit "Golden" në Shijak, Altin Hajri. Alferd Dedja dhe Julian Gjosha njiheshin me njëri tjetrin. Pista e parë e hetimeve: Prishja e pazareve të drogës

- Përgjimet/ Në Janar 2021 Hajri i kërkoi Jurgis Çyrbjas t'i lironte kunatin, Gjoshi
- Viktimës i gjendet pistoletë në trup! Kërkime për autorin në Durrës e Shijak
- SKEDA/ Gjoshi u arrestua në Tiranë më 19 Janar 2021, lëvizte arme në makinë
- VIDEO/ Policia largon trupin e viktimës nga lokali

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
1 Dhjetor, 15:54 | **Përditesimi: 1 Dhjetor, 20:18**

Share

Tiranë- Një 50 vjeçar është ekzekutuar me armë pasditen e sotme (1 dhjetor 2024) brenda në një lokal në Ndroq të Tiranës. Viktima është Alfred Dedja, 50 vjeç, ndërsa autori i dyshuar sipas policisë është Julian Gjoshi, kunati i Altin Hajrit (vëllai i gruas së Hajrit), pronarit të kompleksit "Golden" në Shijak, i kërkuar për rrëmbimin dhe zhdukjen e Jan Prengës në Janar 2020.

Ngjarja ka ndodhur pasditen e sotme (1 Dhjetor), rreth orës 15:30, brenda ambienteve të lokalit, te "Kështjella". Viktima është Alfred Dedja, ishte banor i zonës dhe në lokal ndodhej si klient. 50 vjeçari njihej edhe me pseudonimin "Daku" dhe jetonte mes Italisë e Shqipërisë. Shqiptarja.com dhe Report Tv ka mundur të sigurojë foton e tij.

Ndërkohë policia informoi se është vënë në ndjekje të 27 vjeçarit nga Shijaku,si autor i dyshuar që mendohet se është larguar me një automjet tip "Benz ML", me ngjyrë të zezë në drejtim të Durrësit.

LEXO EDHE:
Ekzekutimi tek lokali 'Kështjella'/ Viktimës i gjendet pistoletë në trup! Kishte punuar dhe si menaxher i kompleksit 'Golden' ku u rrëmbye e zhduk Jan Prenga

Vrasja
Gazetarja e Shqiptarja.com dhe Report Tv Keti Banushi informon se viktima dhe autori kanë pasur njohje mes tyre. Madje pak ditë më parë mendohet se kanë pasur dhe një konflikt mes njëri tjetrit.

Dedja ka qenë i ulur në një prej tavolinave afër xhamit të lokalit. Julian Gjoshi ka hyrë në lokal i pamaskuar. Në momentin kur Dedja ka tentuar ta përqafojë është qëlluar nga 27 vjeçari. Më pas autori është larguar me shpejtësi. 50 vjecari është goditur me dy plumba.

Pista e parë për hetuesit është prishja e pazareve të drogës.

Julian Gjoshi rezulton me precedentë të mëparshëm penalë për armëmbajtje pa leje. Ai është kunati i Altin Hajrit (vëllai i gruas së Hajrit), pronarit të kompleksit "Golden" në Shijak, i kërkuar për rrëmbimin dhe zhdukjen e Jani Prengës në Janar 2020 në Kamëz dhe lidhje e afërt gjithashtu me deputetin e arrestuar Jurgis Çyrbja, i cili i jepte sekrete hetimore që të mos arrestohej gjatë kohës që ishte në kërkim.

> *"Rreth orës 15:30, në një lokal në Ndroq, në rrethana ende të paqarta është vrarë me armë zjarri shtetasi A. D., rreth 50 vjeç. Autori është identifikuar nga shërbimet e Policisë dhe një grup i posaçëm hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për zbardhjen e plotë rrethanave të ngjarjes, dokumentimin e plotë ligjor të saj dhe kapjen e*

autorit të dyshuar", thuhet në njoftimin zyrtar të Policisë së Tiranës.

Ekspertët e policisë në vendngjarje po mbledhin prova materiale dhe dëshmitë e personelit të lokalit si dhe janë sekuestruar kamerat e sigurisë. Vrasja ka ndodhur në një moment kur në lokal ka pasur dhe persona të tjerë.

Ndërkohë në dosjen e SAK në janar 2021 Altin Hajri i ka kërkuar ndihmë ish deputetit të PS-së Jurgis Çyrbja për të liruar kunatin e tij, Julian Gjoshi i cili ishte kapur me pistoletë 'Bereta".

Raportojnë për ngjarjen gazetarët: Keti Banushi e Sokol Dema.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 20:00

Vrasja sot në Ndroq, zbulohen FOTOT e viktimës Alfred Dedja dhe autorit Julian Gjoshi

Alfred Dedja, i vrarë sot në Ndroq

Këta që shihni në foto janë Alfred Dedja, 50-vjeçari që u ekzekutua sot në Ndroq të Tiranës, teksa po drekonte me miqtë e tij dhe Julian Gjoshi, i shpallur në kërkim si autor, 27 vjeç, nga Shijaku.

Mes viktimës dhe autorit ka pasur njohje të hershme, kurse kohët e fundit sipas hetimeve paraprake, kanë pasur edhe konflikte.

Gjoshi, njëkohësisht është edhe kunati i Altin Hajrit, pronarit të shumëkërkuar të kompleksit "Golde" në Shijak, ka hyrë në lokal duke e vrarë direkt Dedjan dhe më pas është arratisur me një "Benz" të zi.

Motiv paraprak besohet se është prishja e pazareve të drogës. Dedja, që njihej edhe me pseudonimin "Daku", jetonte mes Italisë dhe Shqipërisë, pro vite më parë ka qenë menaxher i "Golden". Dedjes iu gjet edhe një armë pistoletë në trup, teksa hetimet po vijojnë.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:43

Ekzekutimi tek lokali 'Kështjella'/ Viktimës i gjendet pistoletë në trup! Kishte punuar dhe si menaxher i kompleksit 'Golden' ku u rrëmbye e zhduk Jan Prenga

Detaje të reja nga vrasje e pasdites së sotme në Ndroq të Tiranës, ku Alfred Dedja, 50 vjeç, i njohur me pseudonimin "Daku", u ekzekutua teksa po drekonte në lokalin "Kështjella".

Gazetari i Shqiptarja.com dhe Report Tv Sokol Dema informon se viktima Alfred Dedja disa vite më parë ka qenë menaxher te kompleksi 'Golden' në Shijak, i cili është në pronësi të Altin Hajrit, i shpallur në kërkim për organizimin e rrëmbimit dhe zhdukjes së trupit të Jani Prengës, më 2020.

Në këtë kompleks dyshohet të jetë mbajtur peng dhe më tej të jetë vrarë 49-vjeçari Jan Prenga në 2020. Kamerat e sigurisë kanë kapur momentin teksa Prenga nxirret me forcë nga një makinë dhe futet në ambientet e kompleksit "Golden"

Mësohet se 50 vjeçarit iu gjet edhe një armë zjarri pistoletë në trup.

Nuk dihet ende nëse vrasja e sotme nga Julian Gjoshi, që rezulton kunati i Hajrit, ka lidhje me rrëmbimin e zhdukjen e Jan Prengës. Pista e parë mbetet gjithnjë prishja e pazareve të drogës.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:31

Momenti kur ekspertët e Policisë lëvizin trupin e Alfred Dedjas nga vendi ku u vra, për ta dërguar në Morg (VIDEO)

Këto janë momentet kur grupi hetimor dhe ekspertët pasi përfundojnë këqyrjen paraprake në vendngjarje, në lokalin ku ndodhi vrasja pasditen e sotme (1 Dhjetor) në Ndroq të Tiranës, kryejnë edhe lëvizjen e trupit të 50-vjeçarit Alfred Dedja.

Të veshur me kostumin e bardhë të ekspertit dhe të ndihmuar nga efektivë të pranishëm civilë, punonjësit me barelë, të mbuluar me çarçaf të bardhë, e zhvendosin viktimën drejt mjetit që do bënte edhe transportin drejt Morgut, për kryerje të veprimeve të tjera proceduriale dhe ekzaminimeve mjeko-ligjore.

Policia ka shpallur në kërkim si autor të krimit Julian Gjoshin, 27 vjeç, nga Shijaku, me precedentë penalë të mëparshëm për armëmbajtje pa leje, në vitin 2021, që njëkohësisht rezulton edhe kunati i të shumëkërkuarit Altin Hajri, pronar i kompleksit “Golden” në Shijak, i akuzuar për organizimin, rrëmbimin dhe zhdukjen e Jani Prengës, në vitin 2020, por që del edhe në përgjimet e SKY ECC me ish-deputetin e arrestuar Jurgis Çyrbja, po për rastin e arrestimit të Gjoshit, me qëllim ndërhyrjen për ta liruar.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:11

Vrasja në Ndroq/ Policia i gjen viktimës Alfred Dedja pistoletë në trup, shumë persona të shoqëruar! Kërkime në Shijak dhe Durrës për autorin Julian Gjoshi

Hetimet për vrasjen e pasdites së sotme në Ndroq të Tiranës janë intensive dhe Policia po vijon me kontrolle, kërkime dhe shoqërime për marrje në pyetje.

Një detaj më i fundit është fakti se edhe viktima Alfred Dedja, i thirrur “Daku”, 50 vjeç, ka qenë i armatosur. Grupi hetimor i ka gjetur një pistoletë në trup, që u sekuestrua si provë materiale.

Kurse Julian Gjoshi figuron një emër i njohur për blutë, i arrestuar me armë pa leje dhe i dehur në muajin janar të vitit 2021, sikurse del edhe në përgjimet e SKY ECC. Gjoshi, nga Shijaku, rezulton kunati i Altin Hajrit, pronarit të kompleksit “Golden” dhe i kërkuar për rrëmbimin dhe zhdukjen e Jani Prengës në vitin 2020.

Gazetari i Report TV, Sokol Dema, informon se Policia ka bërë shoqërime të shumta dhe marrje në pyetje të personave, kryesisht në cilësinë e dëshmitarëve. Viktima ka qenë me persona të tjerë në tavolinë duke drekuar, kur Gjoshi ka hyrë dhe e ka qëlluar direkt me armë disa herë.

Grupi hetimor po punon për të konfirmuar edhe një pistë zyrtare për ngjarjen, teksa dyshohet prishja e pazareve të drogës. Ka pasur edhe konflikte më të hershme mes tyre. Kontrollet janë përqendruar kryesisht në zonën e Shijakut, Durrësit dhe më gjerë.

Viktima jetonte kryesisht mes Italisë dhe Shqipërisë dhe mes dy personave ka pasur njohje të hershme. Dyshohet se autori mund të ketë pasur edhe një person ndihmës për largim nga vendngjarja, por pamjet e mundshme të kamerave të sigurisë mund të zbardhin detaje të tjera nga dinamika e krimit.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:26

Atentati në Ndroq/ Autori, kunati i Altin Hajrit, në janar 2021u kap me armë! I kërkoi ish-deputetit Jurgis Çyrbja t'a lironte! E zbuluan përgjimet

Emri i Julian Gjoshit del edhe në hetimet e Prokurorisë së Posaçme për deputetin socialist të arrestuar, Jurgis Çyrbja.

Bëhet fjalë për një bisedë mes ish-ligjvënësit që akuzohet për shitje sekretesh hetimore dhe Altin Hajrit, pronarit të kompleksit "Golden" në Shijak. Ky i fundit në kërkim për organizimin, rrëmbimin dhe zhdukjen pa gjurmë të Jani Prengës, në janar 2020 në Kamëz, bashkë me persona të tjerë, po për çështje pazaresh droge.

Sipas SPAK, Hajri komunikon me Çyrbjen në Janar 2021 dhe e vë në dijeni për arrestimin e kunatit të tij, Julian Gjoshi (i kapur me pistoletë 'Bereta" më 19 Janar 2021 në Tiranë).

Sip[as përgjimeve në SKY ECC, ai i kërkon të ndërhyjë për ta liruar dhe paguante deri në 20 mijë euro, vetëm të prishej prova. Hajri thekson se i arrestuari ishte kunati i tij dhe se ishte kapur me pistoletë pa leje. Lirimi duhej bërë në seancën e masës së sigurisë, më 21 Janar 2021.

Julian Gjoshi dyshohet se ekzekutoi me armë zjarri sot pasdite (1 Dhjetor), në një lokal në Ndroq, Alfred Dedjan dhe më pas u arratis me një makinë "Benz ML" drejt Durrësit.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:18

SKEDA/ Julian Gjoshi u arrestua në Tiranë më 19 Janar 2021, lëvizte me 'bereta' në makinë dhe 10 fishekë

Pistoleta e sekuestruar më 2021

Julian Gjoshi nuk është emër i panjohur për Policinë. Ai rezulton i arrestuar më 19 Janar 2021 për armëmbajtje pa leje.

Në atë kohë 23 vjeç, Julian Gjoshi u prangos nga forcat "Shqiponja", në Tiranë, teksa lëvizte me makinë.

Kapja e këtij shtetasi u bë në bulevardin "Gjergj Fishta", gjatë kohës që drejtonte mjetin në gjendje të dehur, në masën 0.54 mg/l.

> *"Shërbimet e Policisë kishin marrë informacion në rrugë operative për një shtetas që qarkullonte me armë zjarri. Gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin tip "Ford" me drejtues shtetasin Julian Gjoshi dhe pasagjer shtetasin E. B., poshtë sediljes së drejtuesit të mjetit, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri tip "Beretta" dhe 10 fishekë. Në vijim të veprimeve u procedua penalisht edhe shtetasi E. B., 24 vjeç, pasi dyshohet se kishte dijeni për këtë fakt dhe nuk ka kallëzuar në organet kompetente", thuhet në njoftimin zyrtar të Policisë së Tiranës për atë ngjarje.*

Por Gjoshi është liruar pak kohë më pas.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:27

Vrasja në Ndroq të Tiranës, identifikohet autori, me precedentë penalë! Dyshohet prishja e pazareve të drogës (EMRI)

Lokali ku ndodhi krimi dhe Policia në vendngjarje

Teksa Policia dhe grupi hetimor ndodhen në vendngjarje, duke nisur kërkimet për makinën tip "Benz ML" nga ku u qëllua Alfred Dedja pasditen e sotme, brenda një lokali në zonën e Ndroqit, pranë "Kështjella", zbulohen detajet e para.

Uniformat blu, mbi bazën e provave paraprake kanë identifikuar autorin e dyshuar të krimit, Julian Gjoshi, 27 vjeç, nga Shijaku,që e shpallën në kërkim. Ai rezulton me precedentë të mëparshëm penalë për armëmbajtje pa leje.

Gjithashtu është ngritur edhe pista e parë e dyshuar. bëhet fjalë për prishje të paqareve të drogës, referuar të dhënave operative paraprake, por pa përjashtuar edhe motive të tjera, deri tek një grindje e çastit apo për shkaqe banale.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

A.Q/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Tirane | policia | ndroq | vrasje | Alfred Dedja | Julian Gjoshi | shijak | altin hajri | Jurgis Çyrbja | kompleksi golden

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

28 Nëntor, 09:20

A e keni të qartë pse opozita organizon mosbindje civile?

Po | Jo | Deri diku

Lajme të tjera

LIVE/ Më shumë se 11 mijë tifozë në 'Air Albania', Tirana dhe Partizani po barazojnë 0-0 në derbin e 176-të në histori

1 Dhjetor, 19:00

Gjirokastër/ Në 11 muaj 53 raste të dhunës në familje! Thyhet 'tabuja', urdhër-mbrojtjeje kërkojnë dhe burrat

Piro Nase

1 Dhjetor, 15:44

Aksident me vdekje në Kamëz, arrestohet 30-vjeçari! I riu nga Texas përplaset me 'Audi'-n te Bulevardi i Ri, 4 të plagosur

1 Dhjetor, 12:21

E rëndë në Greqi/ 46-vjeçari shqiptar vret gruan me thikë, vihet në pranga! Plagoset edhe djali, tentoi të shpëtojë të ëmën (FOTO)

1 Dhjetor, 11:19

'Burgu' i të miturve, drogë, plagosje e vrasje, në institutin e riedukimit vuajnë dënimin 29 adoleshentë

30 Nëntor, 21:02

Derbi me Tiranën, Veselinovic: Kemi përballë një skuadër të madhe, Partizani do fitoren

30 Nëntor, 19:14



Derbi Tirana - Partizani, 'Blutë' shoqërojnë tifozët në stadium! Bllokim rrugësh, policia tregon planin e masave

30 Nëntor, 18:12

VIDEO/ Luhet derbi i 176-të, Gugash Magani i Tiranës: Rivaliteti historik, kemi kapacitet për të fituar me Partizanin

30 Nëntor, 16:41

Tiranë/ Arrestohet 42-vjeçari, mbante armë pa leje në banesë (EMRI)

30 Nëntor, 11:25

Krijuan skemë mashtrimi me call-center, Prokuroria Tiranë dërgon në gjyq izraelitin dhe 38 shqiptarë! Dëmi mbi 2 mln euro

Sokol Dema

30 Nëntor, 10:37

KKT miraton lejen për ndërtimin kullave të reja në Tiranë, mes tyre 'Lift Tower' ku do vendoset Kadastra

29 Nëntor, 14:50

Lorenc Vangjeli: Bllokimi i Tiranës/ Dy pamje të ndryshme dhe një palë pranga në mes

Lorenc Vangjeli

29 Nëntor, 14:38

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje